



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 25.06.2013

Nr. 0203 - 808

**PËR:** Ramadan Muja, Kryetar i Komunës së Prizrenit.  
Nijazi Kryeziu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË RREGULLORES TË KOMUNËS  
SË PRIZRENIT, Nr. 01/011-6885, Pranuar me datë, 20.06.2013**

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Rregullores Nr. 01/011-6885, të miratuar me datë 23.05.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Rregullorja Nr. 01/011 - 6885, për Fuqizimin dhe Promovimin e Vullnetarizmit në Komunën e Prizrenit.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
**Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,**

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së  
Arkivit të MAPL-së.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datum: 25.06.2013  
br. 0203 - 808

Za: Ramadan Muja, Gradonačeniik opštine Prizren  
Nijazi Kryeziu, Predsedavajući Skupštine opštine Prizren .

**Predmet:Potvrda zakonitosti uredbe opštine Prizren**  
**, br. 01/ 011-6885, Primijeno dana , 20.06.2013**

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja uredbe br. 01/011-6885, odobreno dana 23.05.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Uredba br. 01/011 - 6885, o jačanju i promociji volontiranja u opštini Prizren .

Sa poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**  
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopije:** Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a  
Rukovodiocima odeljenja MALS-a  
Arhivi MALS-a.



Në bazë të nenit 12 al. 2, pika c, dhe nenit 17 pika r, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të nenit 10 të Ligjit për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë, nenit 17 të Udhëzimit administrativ nr. 9/2010, për përgjegjësitë dhe Procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillave të veprimit rinor në Kosovë dhe të nenit 25 alineja 1 dhe 5, të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur më 23 maj 2013, miratoi këtë:

## Rregullore

### Për Fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit në Komunë

#### Neni 1

#### Dispozitat e përgjithëshme

#### Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit, i marrëdhënieve që krijohen midis vullnetarëve dhe subjektit juridik organizator të vullnetarizmit, për nxitjen dhe zhvillimin e vullnetarizmit në Komunë.

#### Neni 2

#### Fusha e Zbatimit


1. Kjo rregullore, rregullon punën vullnetare të të rinjve në komunë, ku terminologjia bazë e punës vullnetare, principet dhe termat rregullohen si të drejta dhe obligime të vullnetarëve dhe të subjekteve organizatore të vullnetarizmit, kushte për formulimin e kontratave të vullnetarizmit dhe kodeve etike, lëshimin e certifikatave të vullnetarizmit, vlerësim me çmim për vullnetarizmin dhe garantim i implementimit të kësaj rregulloreje.
2. Kjo rregullore trajton të gjitha llojet e marrëdhënieve midis vullnetarëve dhe subjekteve organizatore të vullnetarizmit, gjatë kryerjes së aktiviteteve jofitimprurëse në dobi të një individi tjetër apo të publikut të gjerë.
3. Kjo rregullore aplikohet tek shërbimet dhe aktivitetet komunale, realizimi i të cilave organizohet në mënyrat që rregullon kjo rregullore.

#### Neni 3

#### Përkufizime

Në këtë rregullore përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

- o **Vullnetar** – nënkupton atë siç është përcaktuar në ligj dhe udhëzim administrativ, gjegjësisht, është një individ i cili investon kohë, përpjekje, njohuri apo aftësi vetjake me vullnetin e tij të lirë, në shërbim të aktiviteteve dhe veprimtarive të kryera me qëllim mirëqenien e një individi tjetër apo të publikut të gjerë, që zhvillohen sipas mënyrës që parashikon kjo rregullore, pa kërkuar në



shkëmbim asnjë formë shpërblimi financiar apo material për vullnetarizmin e kryer. Një vullnetar është çdo individ që zotëron një aftësi për punë dhe është vullnetar në Komunë.

- o **Vullnetar minore**n është një vullnetar i ri nën moshën 16 vjeç i cili kryen punë vullnetare në Komunë.
- o **Kontratë Vullnetarizmi** – Kontratë e lidhur me vullnet të lire, midis subjekteve organizatore të vullnetarizmit dhe vullnetarëve, për zhvillimin e aktiviteteve apo veprimtarive jofitimprurëse në dobi të një individi tjetër apo të publikut të gjerë.
- o **Mentor** – është individi lider i cili e bën monitorimin e punës dhe këshillimin e vullnetarit – grupit të vullnetarëve.
- o Përveç përkufizimeve të përcaktuara me këtë rregullore do të shërbejnë edhe përkufizimet e përcaktuara në udhëzimin administrativ për punën vullnetare të të rinjve.

#### **Neni 4**

##### **Përfitimet e komunës nga puna vullnetare**

- o Nxitja e qytetarisë aktive;
- o Ndhmon komunën në realizimin e projekteve në interes publik;
- o Promovimin dhe fuqizimin e vlerave të të rinjve në komunë;
- o Përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve.
- o Forcon bashkëpunimin dhe besimin në mes qytetarëve dhe komunës.
- o Ndhmon komunën në realizimin e interesave të tjera për komunën.
- o Ndhmon komunën në afirmimin e saj në procesin e integritit;
- o Ndhmon integrimin e të rinjve brenda komuniteteve.

#### **Neni 5**

##### **Promovimi**

1. Vullnetarizmi njihet dhe promovohet si një aktivitet i një interesi të veçantë për Komunën, për aq sa përmirëson cilësinë e jetës, stimulon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën shoqërore dhe kontribuon në zhvillimin e një shoqërie më të barabartë, humane dhe më demokratike.
2. Roli i vullnetarizmit dhe rëndësia e tij duhet të përcillen tek fëmijët dhe të rinjtë nëpërmjet aktiviteteve jashtë arsimore në shkollimin e ulët dhe të mesëm. Kjo duhet të përcillet me aktivitet praktik duke i angazhuar nxënësit në punë të dobishme shoqërore.

#### **Neni 6**

##### **Punët të cilat nuk trajtohen si punë vullnetare**

Referuar kësaj rregulloreje, nuk konsiderohet vullnetarizëm si më poshtë:



- o Kryerja e aktiviteteve vullnetare ose ofrimi i shërbimeve që nuk janë në përputhje me ligjin dhe aktet tjera nënligjore.
- o Zhvillimi i aktiviteteve ose ofrimi i shërbimeve kundrejt përfitimit financiar apo material të parregulluar nga kontrata të rregullta sipas ligjit të Punës
- o Kryerja e punëve pa shpërblim natyra e së cilave i përket një marrëdhënie punësimi e cila rregullohet me ligjin e Punës
- o Kryerjen e punëve ose ofrimi i shërbimeve që njëra palë është e detyruar të kryejë për palë të treta siç përcaktohet me ligj apo akte nënligjore
- o Përmbushjen e detyrimeve dhe kryerjen e aktiviteteve që një individ është i detyruar ti zhvillojë për një palë të tretë të përcaktuar me ligj apo rregulloret tjera
- o Zbatimit të detyrimeve të veçanta në përputhje me vendim gjykate
- o Kryerja e veprimtarive ose shërbimeve që janë për përfitim të rrethit familjar apo miqësor.

#### **Neni 7**

#### **Puna vullnetare në Komunë bëhet për interes publik**

#### **Neni 8**

#### **Trajtimi i vullnetarëve**

1. Organizatori i punës vullnetare në komunë është i detyruar për të trajtuar vullnetarë në bazë të parimit të mundësive të barabarta për të gjithë, pavarësisht moshës, racës, gjuhës, fesë, gjinisë, orientimit seksual, bindjeve politike apo të besimit, përkatësisë nacionale apo sociale, gjendjes financiare, arsimit, pozitës shoqërore, gjendjes civile, përgjegjësisë familjare, apo anëtarësimit ose jo-anëtarësimit në një parti etj, aftësive fizike ose mendore, sëmundjeve etj.
2. Aktivitetet lidhur me punët vullnetare që i zhvillojnë partitë politike nuk trajtohen me këtë rregullore.

#### **Neni 9**

#### **Zyrtari komunal për rini dhe mentori**

Zyrtari komunal për rini është përgjegjës:

- o të mbaj regjistrin e vullnetarëve të pranuar nga organizatori i punës vullnetare,
- o ti përcjell regjistrat e vullnetarëve në nivel qendror – Departamentin e rinisë,
- o pranon kërkesat nga organizuesit e punës vullnetare për pajisje me librezë vullnetare,
- o shqyrton kërkesat dhe dokumentacionin tjetër përkatës dhe vendos që të lëshojë nga një librezë për secilin vullnetar të paraqitur,
- o të përcjell ndryshimet eventuale në statusin dhe marrëveshjen e vullnetarit dhe kujdeset që këto ndryshime të jenë në pajtim me këtë rregullore dhe ligj.

- o bënë verifikimin e të dhënave në librezave të pranuar nga organizatori pas përfundimit të punës vullnetare se të njëjtat a janë të plotësuara në pajtim me udhëzimet ligjore dhe marrëveshjen në mes organizuesit të punës vullnetare dhe vullnetarit,
- o bënë vërtetimin e librezave duke i vulosur,
- o kryen edhe punë tjera që lidhen me aktivitetin e punës vullnetare në Komunë e që nuk bie ndesh me ligjin dhe aktet tjera nënligjore.

#### **Neni 10**

Mentori është përgjegjës:

- o bën koordinimin e punëve bashkë me vullnetarin - vullnetarët
- o bën përcaktimin e objektivave të aktivitetit për zhvillimin e punës vullnetare;
- o për monitorimin e punës dhe këshillimin e vullnetarit – grupit të vullnetarëve,
- o bënë raport për zhvillimin e punës nga ana vullnetarit, ku përfshinë orët vullnetare të mbajtura, sfidat gjatë kryerjes së punës vullnetare, trajnimet që janë propozuar në mes vullnetarit dhe mentorit, efektet e arritura të cilat do të maten nga sukseset në punë, aftësitë e veçanta që janë treguar nga vullnetari,
- o kryen edhe detyrat tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore.

#### **Neni 11**

- o Kriteret dhe kushtet të cilat duhet t'i plotësoj një mentor duhet t'i caktoj organizuesi i punës vullnetare.
- o Mentori duhet të ketë vlera morale dhe përvojë relevante.

#### **Neni 12**

##### **Obligimet e vullnetarëve**

Obligimet e vullnetarëve janë ato të cilat janë të përcaktuara me udhëzim administrativ.

#### **Neni 13**

##### **Lidhja e marrëveshjes për punë vullnetare**

Lidhja e marrëveshjes për punë vullnetare bëhet në pajtim me udhëzimin administrativ.

#### **Neni 14**

##### **Kompensimi i dëmit**

Kompensimi i dëmit caktohet në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë fushë.

#### **Neni 15**

#### **Përfundimi i punës vullnetare**

Përfundimi i punës vullnetare bëhet në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë fushë.

#### **Neni 16**

#### **Motivimi i vullnetarëve**

- o përparësi në përfitimin e bursave;
- o përparësi në shërbimet publike komunale;
- o përparësi në pjesëmarrje në trajnime;
- o shfrytëzimin e objekteve publike për aktivitete e organizatave vullnetare;
- o ndarja e shpërblimeve për punën vullnetare;
- o promovimi i rezultateve nga puna vullnetare në mjetet publike për publikim (Ueb faqe, etj, gazeta, revista, fletëpalosje);
- o organizimi i aktiviteteve kulturore për vullnetarë
- o përfshirja e vullnetarëve në organizimin e aktiviteteve kulturore të organizuar nga komuna;
- o ofrimi i mundësive për kryerjen e punës praktike në institucionet publike-administratë komunale;
- o organizimi i fushatës promovuese të vullnetarizmit.

#### **Neni 17**

#### **Integrimi i punës vullnetare-brenda planit të veprimit**

Aktivitetet e punës vullnetare duhet të jenë pjesë e planit të punës, planit të veprimit dhe çdo dokumenti tjetër të Drejtorisë përgjegjëse për rini.

#### **Neni 18**

#### **Vullnetarizmi brenda KVRL dhe qendrave rinore**

Aktivitetet e kryera ose shërbimet e ofruara nga KVRL dhe Qendra rinore që veprojnë brenda komunës parim kryesor e kanë punën vullnetare, nëpërmjet së cilës bëjnë ngritjen e vetëdijes për punë vullnetare të anëtarëve të saj.

#### **Neni 19**

#### **Baza e të dhënave**

Zyrtari rinor i ndihmuar nga KVRL dhe qendra rinore, ka obligim që të mbaj bazën e të dhënave me qëllim të monitorimit të punës vullnetare në punë;



**Neni 20**

**Buxheti**

Aktivitetet e punës vullnetare duhet të jenë pjesë e planifikimeve buxhetore komunale

**Neni 21**

**Puna vullnetare gjatë procesit mësimor**

Aktivitetet e punës vullnetare nuk mund ti përcjellin nxënësit gjatë procesit mësimor.

**Neni 22**

**Mbikëqyrja**

Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje e bën Kryetari i Komunës kurse zbatimin e saj e bën Drejtorja përkatëse, përgjegjëse për rini

**Neni 23**

**Dispozitat përfundimtare**

Aspektet e vullnetarizmit të rregulluara me këtë rregullore, si dhe marrëdhëniet që lindin nga kontrata e vullnetarizmit që nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore janë objekt i dispozitave të përgjithshme ligjore.

**Neni 24**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit, dhe do të shpallet në “Kumtar”.

**KOMUNA E PRIZRENIT**  
Kuvendi Komunal  
Nr. 01/011-6885  
Më 23 maj 2013  
Prizren

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Nijazi Kryeziu**

